



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Tiranë, më 11.1. 2019

NJOFTIM

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me cilësinë e Autoritetit të Sigurimit Kombëtar në fushën e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të NATO-s, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, gjen rastin të bëjë këtë njoftim publik:

Pajisja me Certifikatën e Sigurimit të Personelit për z. Gent CAKAJ është kryer në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke respektuar detyrimet e parashikuara në Ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar dhe Vendimin Nr. 188, datë 4.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”.

Lidhur me këtë proces sqarojmë se:

- 1. Verifikimi i sigorisë për z. Gent CAKAJ është kryer i plotë, me përparësi dhe në përputhje me detyrimet ligjore**, parashikuar në Vendimin Nr. 188, datë 4.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit” dhe specifikisht të neneve 11¹, 12², 13³, 14⁴, 17⁵, 18⁶, 19⁷ të tij.

DSIK administron përgjigjet zyrtare të Autoriteteve Verifikuese brenda vendit; SHISH, SHÇBA, si dhe të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), si i vetmi Autoritet Verifikues i Republikës Kosovës, (*pasi z. Cakaj mban edhe shtetësinë e Kosovës, krahas shtetësisë shqiptare*).

Referuar përgjigjeve të Autoriteteve Verifikuese ka rezultuar se për z. Gent CAKAJ nuk ekziston rrezik i papranueshëm sigurie për pajisjen e tij me CSP, sipas kërkesës së paraqitur nga MEPJ.

Nga procesi i verifikimit të sigorisë të z. Gent CAKAJ nuk ka rezultuar asnjë rrethanë ligjore⁸, sipas së cilës DSIK ka qenë e detyruar për të kërkuar informacion shtesë, apo për të shtrirë verifikimet e sigorisë në vende të tjera si Hungaria e Belgjika, të cilat gjithsesi janë vende anëtare të NATO dhe BE.

¹ Shqyrtimi fillestar

² Kushtet për fillimin e verifikimit të sigorisë

³ Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigorisë

⁴ Kriteret themelore të vlerësimit të sigorisë

⁵ Koha që mbulon verifikimi i sigorisë

⁶ Afatet e kryerjes së verifikimit të sigorisë

⁷ Rrethi i personave që verifikohen

⁸ Shih: *Vendimi Nr. 188, datë 4.3.2015, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”*.

2. Procedurat e verifikimit të sigurisë janë ndjekur me angazhim maksimal brenda afateve kohore të parashikuara në nenin 18 të VKM së sipërcituar.

Kujtojmë, se në përmbajtjen e këtij neni, ndër të tjera është parashikuar se:

“*Afati i përgjithshëm* për kryerjen e procedurave të verifikimit dhe lëshimit të CSP-së nga DSIK-ja është *deri në 120 ditë kalendarike*. Brenda kësaj periudhe përfshihen edhe afatet e verifikimit të sigurisë nga ana e autoriteteve verifikuese.....”⁹ Në vijim thuhet se:

“...*Autoriteti verifikues* dhe çdo strukturë tjetër shtetërore, që merr kërkesën e paraqitur nga DSIK për të kryer verifikimin e sigurisë, ka detyrimin të kryejë procedurat dhe të kthejë përgjigje duke dhënë informacionin e kërkuar me shkrim, *jo më vonë se 45 ditë kalendarike* nga data e marrjes së kërkesës”¹⁰

DSIK, me cilësinë e Autoritetit të Sigurimit Kombëtar, vlerëson bashkëpunimin e ngushtë me Autoritetet Verifikuese brenda vendit dhe strukturën homologe të Republikës së Kosovës, që kanë kryer procedurat e verifikimit të sigurisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Së fundi një sqarim plotësues, lidhur me “*Certifikatën e sigurimit të personelit*”.

“Certifikata e sigurimit të personelit”¹¹, është dokumenti zyrtar i DSIK¹², ose i një autoriteti kompetent të sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton nga pikëpamja e sigurisë se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Posedimi i këtij dokumenti përben një nga kriteret¹³ që duhet të plotësojë një individ, **përpara** se të njihet me informacionin e klasifikuar, (me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar në nivelin “I kufizuar” që nuk kërkohet CSP).

Pra, aplikimi dhe pajisja me CSP është e detyrueshme vetëm për një individ që do të njihet me informacion të klasifikuar **bazuar në parimin “nevojë për njohje”**.

Nga ana tjetër, sigurimi i personelit, si një nga disiplinat kryesore të sigurimit të informacionit të klasifikuar, është një proces i vazhdueshëm dhe nuk përfundon me lëshimin e CSP. Në çdo rast, kur dalin të dhëna të reja që rezultojnë me rrezik të papranueshëm sigurie, DSIK rishqyrton vendimin e marrë.

DSIK administron dokumentacion të plotë lidhur me procedurat e ndjekura dhe informacionin e përfutur në funksion të verifikimit të sigurisë dhe të pajisjes me CSP të z. Gent CAKAJ.

Ju faleminderit.

⁹ Neni 18, paragrafi i parë.

¹⁰ Neni 18, paragrafi i tretë.

¹¹ Neni 3, pika 6 e VKM

¹² Shiko në pikën 2 të Vendimit Nr. 377, date 31.5. 2001 të Këshillit të Ministrave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar ‘sekret shtetëror’ në marrëdhënie ndërkombëtare “, i ndryshuar, ku ndër të tjera është përcaktuar se *Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar është Autoriteti i Sigurimit Kombëtar në fushën e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, me NATO-n, me shtetet dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.*

¹³ Për më tepër Neni 4, (specifikisht neni 4, germa ç).